

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dita e 120-të e protestës - VIDEO/ Qytetari: Rama asnjë takim të nivelit të lartë në OKB, por vetëm foli k eq për popullin e tij
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919569/video-qytetari-rama-asnje-takim-te-nivelit-te-larte-ne-okb-por-vetem-foli-keq-per-popullin-e-tij/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:49:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:40:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4ec92d7e7b1b0d7861f34fbcabb4a8de9863c86cd94e62d8777babb8c2392a9
TEKSTI	b98fe81f2c1423dcdf46034ecf6872dd7cd09bb48b4019f6c4e97c6e141f00ac
PAMJA	7725bcc52df1cc885b9c8e4afcfa5ee17dbd52a448efc490a2ba9baacb2ed442

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	84b8ee3b6d9c783526dcd8fe1aed78fe4b739ce8cf35c8f6e0de786dc218219c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	67690963e34eac89a6c1ba46d066d36b47b728bdbf8bf8d029d400ef1ab927ee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/84b8ee3b6d9c783526dcd8fe1aed78fe4b739ce8cf35c8f6e0de786dc218219c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEÇA


'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiqit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

LAJMI I FUNDIT

LIVE - 'Rama jepe dorëheqjen', protesta e 120-të, qytetarët nisin marshimin në rrugët e Tiranës

më të lexuarat



'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s'menaxhon dot më



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!



VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë Hysenit?



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Berisha: Vlorë Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan



Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



VIDEO/ Qytetari: Rama asnjë takim të nivelit të lartë në OKB, por vetëm foli keq për popullin e tij

20:40, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Protesta qytetare vijon për të 120-ën ditë radhazi, ndërsa një prej qytetarëve që mori fjalën para protestuesve ka komentuar vizitën e kryeministrit Edi Rama në New York dhe pjesëmarrjen e tij në punimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Qytetari u ndal te takimet e Ramës gjatë qëndrimit në OKB, duke pretenduar se kryeministri shqiptar nuk zhvilloi asnjë takim të nivelit të lartë.

'Edi Rama ishte i vetmi udhëheqës, i vetëm, në mbledhjen e fundit të Kombeve të Bashkuara, i cili nuk zhvilloi asnjë takim të nivelit të lartë', deklaroi ai.

Sipas tij, në vend që vizita në OKB të shfrytëzohej për takime diplomatike, Rama foli për situatën në Shqipëri dhe për qytetarët shqiptarë.

'Përsëritetja të gjithëve!'

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ishte i vetmi udhëheqës, i vetëm, në mbledhjen e fundit të Kombeve, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili nuk zhvilloi asnjë takim të nivelit të lartë.

Madje nuk takoi as shokët e tij diktatorë me të cilët shoqërohet zakonisht. Por gjithashtu ishte i vetmi kryeministër në atë organizatë ku flasin udhëheqës jo vetëm demokratikë, por shumica e tyre edhe diktatorë e autoritarë, i cili foli keq kundër popullit të tij.

E bëri popullin e tij objekt të diskutimeve në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Madje jo vetëm kaq, ai pështyu dhe ofendoi njerëzit të cilët prej tre muajsh e më tepër mbledhen në këtë shesh në një protestë të jashtëzakonshme, jo vetëm për

historinë e shqiptarëve, por edhe rajonit e me gjërë.

Por si të mos mjaftonte ky dështim, kjo vetmi e madhe e liderit tonë global, në 24 orët e fundit ai organizoi edhe një dështim... duke shkuar madje në Rinas.

Në vendin ku qindra mijëra shqiptarë janë larguar në 10 vitet e fundit nga qeverisja e tij, ku i numëron radhët e gjata si turistë dhe turistë të tij shenjtore... pra edhe konferencën e jashtëzakonshme që na e bëri në Rinas dhe ku i gjithë populli priste prej tij dorëheqjen, ai e shtyu konferencën, bëri vetëm një video dhe e vazhdoi me demagogjinë e tij të zakonshme.

Edi Ramës i kanë mbetur vetëm dy rrugë: të japë dorëheqjen, ose të bëhet mbret. Rrugë të mesme nuk ka. Mirë do ishte të jepte dorëheqjen, por paradoksalisht dhe ironikisht, nuk do ishte keq edhe sikur të bëhej mbret. Kështu ai nuk do ta përdorte më demokracinë për të mbrojtur pozicionin e vet.

Nuk do na e përdorte më demokracinë për të sunduar përmes votave të vjedhura. Nuk do të kishte të nevojshme ta grabiste Shqipërinë edhe për të blerë vota, por nëse do të bëhej mbret do të vidhte vetëm për veten e vet.

Nuk do ta kishte të nevojshme të bënte aleancë me krimin edhe me Illumin për të mbetur në pushtet.

Pra, Edi Rama nuk ka rrugë tjetër të mesme. Sepse nuk mund të quajmë, nuk mund ta quajmë shtet vatikani, arrestin shtëpiak për shefin e opozitës në një vend ku njeriu bën burg nëse ndërton një avlli pa leje.

Nuk mundet të ofrojë imunitet e mbrojtje politike e parlamentare për Belinda Ballukun kur të rinjtë tërhiqen zvarrë me polici përballë parlamentit.

Rrugë tjetër nuk ka për Edi Ramën. Prandaj, Rama jep dorëheqjen! Rama jep dorëheqjen!, tha i riu gjatë protestës te kryeministria.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Përfundojnë fjalimet para Kryeministrit, qytetarët vijnë marshimin në Tiranë: Rama jep dorëheqjen



SYRI TV/ Abuzimet me konçensionet PPP, gati gjysma e pagesave nën hetim



'Më 3 tetor diaspora protestë në Bruksel'/ Qytetari kërkesë për PE-në: Ndaloni takimet me Ramën

TË NGJASHME



'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Skandali i SHISH/ Muçollari: Rama do që krimi të mos merret vesh, jo që të mos ndodhë



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!



Protesta e 120-të kundër Ramës, qytetarët marshojnë nga Sheshi Skënderbej drejt Kryeministrit



VIDEO/ Fjalimet në OKB, Maliqi: Rama foli për veten e tij, Kurti kishte në fokus çështjet e Kosovës



Droga po shkon tek fëmijët tanë!

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftoj të bëni klikime dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Syri i SYRI.net

Reklamën duhet të regjistrojë të paktën një nga shprehjet e mëposhtme që ju mëndohet të vendosni: ©, TM, ®, ®.

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.